



Pranuar / Dorezuar Priljena / Predato Received / Delivered	04.12.2023	3	viti god year
Organ / Shënia Organ / Jednitca Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojra Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHK/7220/2023			113



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1417/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtarë; me Ilire Mehmeti-Shaqiri Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1417/2023, të datës 15.11.2023, të parashtruar nga ankuesi te cilin me autorizim e përfaqëson avokate kundër organit të punësimit: Universiteti i Prishtinës, në çështjen juridike „Kontestim Konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën, paragrafin 1.1 nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.8; të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 01.12.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.1417/2023, të datës 15.11.2023, të parashtruar nga ankuesi përmes përfaqësueses me autorizim avokate

II. Çështja bije në kompetencë të gjykatës se rregullt.

A r s y e t i m

Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” me date 31.08.2023 ka shpallur kërkesën për konkursin plotësuese për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime në Fakultetin Filozofik.

Ankuesi me date 20.09.2023 ka parashtruar ankesë pranë Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” në Fakultetin Filozofik me pretendim se i njëjti i ka plotësuar të gjitha kushtet respektivisht ka dorëzuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas konkursit dhe i njëjti nuk është përzgjedhur për pozitën e lartcekur. Ndërsa me date 16.10.2023 Komisioni i Ankesave i është përgjigjur ankuesit ku ka refuzuar ankesën e ankuesit me arsyetimin se komisioni i vlerësimit ka ne diskrecion të vendos në bazë meritore për arritjet dhe profilin profesional të aplikuesit qe propozon, po ashtu komisioni i ankesave konstaton se Komisioni i Vlerësues ka zbatuar drejte dispozitat relevante të “Rregullores për procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”.

Ankuesi i pa kënaqur me përgjigjen e datës 16.10.2023, me datë 15.11.2023 ka parashtruar ankese pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me pretendim se Komisioni Vlerësues dhe Këshillin i Fakultetit Filozofik nuk ka shqyrtuar dhe vlerësuar dokumentacionin ashtu siç duhet.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vendosje meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 1417/2023 të datës 15.11.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 28.09.2023 lidhur me përfaqësimin e ankuesit; Përgjigjen e datës 16.10.2023 të Fakultetit Filozofik; Ankesën e datës 20.09.2023 të ankuesit të parashtruar në Universitetin Prishtinës "Hasan Prishtina"; Kërkesën e datës 31.08.2023; Biografin -CV e ankuesit; Certifikatën e datës 30.08.2023; Diplomën e datës 10.07.2013; Shkresën nën shenjen Lrp.nr.1489/2022 të lëshuar nga noteri [redacted] Pasqyrën e notave të datës 28.07.2015; Kontratën e punës të mësimdhënies të datës 29.09.2015; Kontratën e datës 29.09.2015; Kontratën e punës të datës 11.03.2014; Kontratën e punës të datës 20.11.2014; Vendimin e datës 26.11.2014; shkresën nën shenjen Lrp.nr.1488/2022 të lëshuar nga noteri [redacted] Certifikatën mbi dënimet penale të lëshuar nga Sistemi Qendror i evidencave penale të Kosovës; Kontratën e punës të datës 01.11.2021; Certifikatën e datës 02.10.2015; Certifikatën e datës 07.12.2015; Certifikatën e lëshuar në vitin 2015; Certifikatën e datës 18.05.2017; Certifikatën e datës 11.08.2017; Certifikatën e datës 18.05.2017; Certifikatën e datës 11.08.2017; Raportin e Komisionit Vlerësues për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, **nuk është kompetent** për të vendosur për ankesën me numër A.nr.1417/2023 të datës 15.11.2023 të parashtruar nga ankuesi [redacted] **sepse:**

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në kuptim të pranushmërisë së ankesës ju referua dispozitave të Ligjit NR.06/L-114 për Zyrtar Publik përkatësisht nenit 2 ku përcaktohet se 3. *Nëpunës Civil- është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë.* 4. *Nëpunës i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike, dhe si rrjedhojë ka konstatuar se zyrtarët publikë të nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe shërbimeve të brendshme pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit gjegjësisht zyrtarët publike në kuadër të institucioneve publike të arsimit të lartë në Kosovës, kanë statusin e nëpunësit të shërbimeve publike, respektivisht të njëjtit nuk janë nëpunës civil që nënkupton se pozita e punës në të cilin ankuesi ka konkurruar nuk është pozitë e shërbimit civil, andaj duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm*

ankesat e nëpunësve civil dhe kandidateve për pranim në Shërbim Civil, Kolegji konstaton se Këshilli i Pavarur MbiKëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën me numer A.nr.1417/2023 të datës 15.11.2023 të parashtruar nga ankuesit si në dispozitiv të vendimit.

Në kuptim të dispozitave të nenit 24 paragrafit 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nëpunësi i shërbimit publik ka të drejtë të ankohet të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest pune në gjykatën kompetente, mirëpo meqenëse nga shkresat e lëndës vërehet se ankuesi ka shfrytëzuar mjetet juridike pranë organit punëdhënës, Kolegji i Këshillit udhëzon ankuesin për ushtrimin e mjeteve juridike në gjykatë të rregullt në pajtim me dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në dispozitat e nenit 24 dhe 74 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konstaton se zyrtarët publikë me status të nëpunësit të shërbimit publik kanë të drejtë të ankohen të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojnë kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nenparagrafi 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur MbiKëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1417/2023

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse

Malsore Gashi-Bajraktari

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësueses me autorizim
- Udhëheqësit të Personelit në Universitetin e Prishtinës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

